



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

nr. 430, datë 7.09.2016

“Për

hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|-------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetare |
| • Servete GRUDA | zv/Kryetare |
| • Iva ZAJMI | Anëtare |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Eduard YPI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 07.09.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi çmimet e sigurimit të detyrueshëm ndaj palëve të treta (MTPL)”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi çmimet e sigurimit të detyrueshëm ndaj palëve të treta (MTPL)” dhe monitorimit në kete treg,

VËREN SE:

1. Nisur nga artikujt në median e shkruar, në lidhje me një rritje të çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) nga të gjitha kompanitë e sigurimeve me rreth 25%, më datë 24.08.2016, Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës realizuan një monitorim pranë agjentëve të shitjes së policave të sigurimit.
2. Nga monitorimi i realizuar pranë agjentëve të shitjes së policave të sigurimit, si dhe nga deklaratimet e këtyre të fundit, konstatohet se më datë 24.08.2016, është realizuar rritja e çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta

(MTPL) për të gjitha kategoritë dhe nga të gjitha kompanitë e sigurimit në masën prej 20%.

3. Kjo rritje është reflektuar në sistemin online të prerjes së policave të sigurimit (MTPL) të agjenteve të sigurimeve të të gjitha kompanive të sigurimit më datë 24.08.2016, dhe vërehet se këto prime shitje ndryshojnë në mënyrë simetrike nga njëra kompani sigurimi tek tjetra, me të njëjtën masë prej 12 lekë, sjellje kjo e cila mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar sipas përcaktimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme);
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga 01 Janar 2016 deri më 07 Shtator 2016;
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj, si dhe paraqitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 23.09.2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Zv/Kryetare

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtare

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R E